

# Ligj për arsim dhe trajnim profesional

Ligj për arsim dhe trajnim profesional ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2006; 117/2008; 148/2009; 17/2011; 24/2013; 137/2013 dhe 41/2014).

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet organizimi, struktura dhe administrimi me sistemin e arsimit dhe të trajnimit profesional.

### *Definicione*

Neni 2

Nocionet e caktuara, të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. **Arsim dhe trajnim profesional** është pjesë e sistemit të arsimit që siguron zhvillim individual të personalitetit përmes fitimit të kompetencave, njohurive dhe aftësive të domosdoshme për inkuadrim në tregun e punës ose vazhdimin e arsimimit.
2. **Institucion për arsim dhe trajnim profesional** është institucioni, veprimtaria kryesore e të cilit është arsimimi dhe trajnimi profesional.
3. **Punëdhënës** janë shoqëria tregtare, institucioni ose zejtari, te të cilët realizohet trajnimi praktik sipas kushteve rrjedhëse të aktivitetit të tyre, me ç'rast ky trajnim nuk paraqet veprimtarinë e tyre kryesore.
4. **Partnerë socialë** janë shoqata që i përfaqësojnë interesat e punëtorëve dhe punëdhënësve, të cilët në bashkëpunim me organet e administratës shtetërore, njësitë e vetadministrimit lokal e realizojnë sistemin e arsimit dhe të trajnimit profesional.
5. **Standardi i profesionit** është caktimi i llojit të profesionit, niveli dhe kërkesat e punës dhe kompetencat, njohuritë e zhdërvjelltësitë e duhura.
6. **Moduli** shënon njësinë e pavarur të të mësuarit, që si njësi programore mundëson fitimin e kompetencave, njohurive dhe zhdërvjelltësive nga sfera e caktuar.
7. **Diploma, certifikata** janë dokumente publike me të cilat vërtetohet mbarimi i programit të caktuar për arsimim dhe trajnim profesional.

### *Përfshirja e arsimit dhe trajnimit profesional*

Neni 3

Arsimi dhe aftësimi profesional përfshin:

- **arsimin dhe trajnimin e mesëm profesional**, i cili është pjesë e arsimit të mesëm që mundëson fitimin fillestar të nivelit të parë, të dytë apo të tretë të kualifikimeve profesionale;
- **arsimin dhe trajnimin profesional pas kryerjes së arsimit të mesëm**, i cili është pjesë e sistemit të arsimit që u mundëson personave që kanë kryer arsimin e mesëm, ta kryejnë nivelin e katërt të kualifikimeve profesionale.

### *Qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe trajnimit profesional*

Neni 4

Qëllimi i arsimit dhe trajnimit profesional është aftësimi për punë, përkatësisht për vazhdimin e arsimimit.

Detyrat e arsimit dhe trajnimit profesional janë:

- të sigurojë arsimim të përgjithshëm cilësor e profesional në pajtim me nivelin bashkëkohor të shkencës, teknologjisë e kulturës;
- të krijojë kushte për fitimin dhe përsosjen e niveleve përkatëse të kualifikimeve profesionale në pajtim me nevojat e tregut të punës;
- të nxitë interesimin për arsimin dhe trajnimin profesional;
- të zhvillojë kompetenca, njohuri e shkathtësi të domosdoshme për aktivitetet profesionale të personit, si dhe për vetëpunësim në kuadër të shoqërisë së bazuar në principet e tregut e të demokracisë;
- të sigurojë baza për mësim të përjetshëm.

### *Sistemi i arsimit dhe i trajnimit profesional*

Neni 5

Arsimimin dhe trajnimin profesional, sipas këtij ligji, e kryejnë institucionet për arsim dhe trajnim profesional, punëdhënësit dhe partnerët socialë.

Institucione për arsim dhe trajnim profesional janë:

- shkollat për arsim dhe trajnim profesional që realizojnë arsimim të përgjithshëm profesional e teorik dhe trajnim praktik;
- qendrat për trajnim profesional në të cilat realizohet arsimimi teorik profesional dhe trajnimi praktik.

## II. KOMPETENCAT NË ARSIMIN DHE TRAJNIMIN PROFESIONAL

### *Kompetencat në arsimin dhe trajnimin profesional*

Neni 6

Kompetent për arsimin dhe trajnimin profesional janë ministria kompetente e arsimit (ne tekstin e mëtejme: Ministria), ministria kompetente e punës, Këshilli për arsim e trajnim profesional dhe partnerët socialë.

### *Kompetencat e Ministrisë në sferën e arsimit dhe trajnimit profesional*

Neni 7

Ministria ka kompetencë:

- t'i propozojë Qeverisë rrjetin e institucioneve për arsim dhe trajnim profesional;
- të japë mendim për pushimin me punë të institucioneve për arsim dhe trajnim profesional, në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- të bëjë verifikimin e institucioneve për arsim dhe trajnim profesional, në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- të kryejë akreditimin e institucioneve që do të organizojnë trajnimin e arsimtarëve;
- të miratojë plan-programe arsimore nacionale në kornizë;
- në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Republikës së Maqedonisë, Lidhjen e Odave të Republikës së Maqedonisë dhe Odën e Zejtarëve të Maqedonisë (ne tekstin e mëtejme: odat) të kryejë kontrollin e punëdhënësve për plotësimin e kushteve për realizimin e trajnimit praktik dhe për marrëveshjet e lidhura ndërmjet institucionit për arsim dhe trajnim profesional, punëdhënësit dhe nxënësit, për realizimin e trajnimit praktik;
- me propozimin e Qendrës për arsim dhe aftësim profesional (ne tekstin e mëtejme: Qendra) miraton planprogramin arsimor për trajnimin profesional didaktik të trajnuesve nga punëdhënësit të cilët realizohet trajnimi praktik;
- me propozim të Qendrës, e me mendim pozitiv të marrë paraprakisht nga Byroja për Zhvillim të Arsimit, miraton koncepte për të gjitha llojet e arsimit dhe trajnimit profesional,
- me propozim të Qendrës, e me mendim pozitiv të marrë paraprakisht nga Byroja për Zhvillim të Arsimit, miraton programe të provimeve për provim përfundimtar dhe maturë shtetërore, të përgatitura në pajtim me standardet për realizimin e provimeve në fund të çdo lloji të arsimit dhe trajnimit profesional,
- me propozim të Qendrës, miraton standarde për arritjet e nxënësve në arsimin dhe trajnimin profesional,
- me propozim të Qendrës, e me mendim pozitiv të marrë paraprakisht nga Këshilli për Arsim dhe Trajnim Profesional, miraton standarde për profile arsimore dhe standarde për degë profesioni
- të kryejë punë të tjera në pajtim me ligjin.

## *Kompetencat e Ministrisë, kompetente për punë në sferën e arsimit dhe trajnimit profesional*

Neni 8

Ministria kompetente e punës ka kompetencë:

- të marrë pjesë në realizimin e politikës shtetërore në sferën e arsimit dhe trajnimit profesional, në pajtim me këtë ligj;
- t'i shqyrtojë nevojat për kuadrin e arsimit e trajnimit profesional, përmes analizave të tregut të punës dhe të paraqesë mendimin për politikën regjistruese, në Këshill;
- të marrë pjesë në përgatitjen e harmonizimit e kualifikimeve profesionale sipas standardeve;
- në bashkëpunim me Qendrën, të iniciojë nevojat për përgatitjen e kualifikimeve të reja profesionale sipas standardeve;
- me propozim të Ministrisë, e me mendim pozitiv paraprak të Këshillit, miraton standarde të profesioneve të përgatitura nga Qendra,
- të marrë pjesë në organizimin e orientimit profesional të nxënësve;
- të kryejë mbikëqyrjen e dispozitave për kushtet e mbrojtjes gjatë realizimit të trajnimit praktik.
- e përcakton Listën e standardeve të profesioneve për arsim dhe trajnim profesional dhe e shpall në "Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë".

## *Këshilli për arsim dhe trajnim profesional*

Neni 9

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me vendim themelon Këshillin për arsim e trajnim profesional (në tekstin e mëtejme: Këshilli) si trup këshillëdhënës që propozon çështje strategjike që kanë të bëjnë me politikën e zhvillimit të arsimit e trajnimit profesional.

Këshilli përbëhet prej 11 anëtarësh, prej të cilëve: tre anëtarë nga ministria, prej të cilëve një anëtar është nga Byroja e zhvillimit të arsimit, nga një anëtar i Odave, nga një anëtar i ministrisë kompetente të punës, ministrisë kompetente të ekonomisë, ministrisë kompetente të financave, sindikatës shumicë, Bashkësisë së njësisive të vetadministrimit lokal dhe Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe përkatës të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, duke pasur parasysh gjuhët në të cilat mbahet mësimi në arsimin e mesëm, pa u cenuar kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Në punën e Këshillit merr pjesë edhe drejtori i Qendrës, pa të drejtë vote në vendimmarrje.

Këshilli e zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të vet. Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat pesë vjet.

Këshilli e rregullon punën e tij me rregullore. Për punën e vet Këshilli përgatit raportin vjetor dhe e dorëzon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe në Ministri.

Punët profesionale administrative të Këshillit i kryen Qendra.

Kompetencat e Qendrës janë:

- jep mendim për strategjinë e zhvillimit të arsimit dhe trajnimit profesional;
- i propozon Ministrisë ndryshime e plotësime të Listës së standardeve të profesioneve për arsimin dhe trajnimin profesional;
- i propozon Ministrisë kualifikime e standarde nacionale të profesioneve;
- në bashkëpunim me komunat, në Ministri dorëzon propozim për zhvillimin e rrjetit të institucioneve për arsim e trajnim profesional.
- jep mendim për standardet e profesionit në Ministri,
- jep mendim për standardet për profilet arsimore dhe standardet për degë profesioni në Ministri

### ***Kompetencat e njësive të vetadministrimit lokal në sferën e arsimit e trajnimit profesional***

Neni 10

Këshilli i komunës, përkatësisht i Qytetit të Shkupit:

- kryen analizën e nevojave të tregut të punës në nivel lokal dhe i paraqet shqyrtimet për nevojat, në Qendër dhe në institucionet për arsim e trajnim profesional;
- paraqet propozime në Ministri dhe në Qendër, për nevojat e zhvillimit të plan-programeve mësimore;
- paraqet propozime në Ministri, për politikën regjistruese në arsimin e trajnimin profesional.

### ***Partnerët socialë në fushën e arsimit dhe trajnimit profesional***

Neni 11

Dhomat i kryejnë punët si vijojnë:

- paraqesin propozime pranë Qendrës për miratimin e planeve dhe programeve të reja mësimore dhe për përtëritjen e planeve dhe programeve ekzistuese mësimore;
- paraqesin propozime pranë Qendrës për përpilimin e standardeve të reja të profesioneve;
- marrin pjesë në komisionet e provimeve përfundimtare të arsimit dhe trajnimit profesional;
- mbajnë Regjistër të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet institucioneve të arsimit dhe trajnimit profesional me punëdhënësit, për trajnim praktik të nxënësve;
- pranë ministrisë paraqesin raport vjetor për punëdhënësit e verifikuar për realizimin e trajnimit praktik.

Neni 12

Sindikata shumicë paraqet propozime për përmirësimin e kushteve të trajnimit praktik të nxënësve te punëdhënësit.

### ***Verifikimi i punëdhënësve për realizimin e trajnimit praktik***

Neni 13

Punëdhënësit mund ta kryejnë trajnimin praktik të nxënësve, në qoftë se i përmbushin kushtet në lidhje me lokalitetin, pajisjen dhe kuadrin përkatës.

Standardet për pajisjen dhe kushtet e lokalit nga paragrafi 1 të këtij neni, i përpilon Qendra, ndërsa i miratojnë dhomat për fushën e vet.

Standardin për kuadër profesional dhe për kuadër tjetër për realizimin e trajnimit praktik te punëdhënësit e përpilon Qendra, ndërsa e miratojnë dhomat sipas mendimit paraprak pozitiv të ministrisë.

Verifikimin e përmbushjes së kushteve nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, e bëjnë dhomat.

Dhomat mbajnë Regjistër për verifikimin e punëdhënësve për trajnim praktik.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit për verifikimin e punëdhënësve për trajnim praktik e përcakton ministri kompetent i arsimit (në tekstin e mëtejme: ministri).

### **III. ORGANIZIMI I ARSIMIT DHE TRAJNIMIT PROFESIONAL**

#### ***Të drejtat dhe obligimet e institucioneve për arsim dhe trajnim profesional***

Neni 14

Institucioni për arsim dhe trajnim profesional ka të drejtë:

- të organizojë dhe realizojë arsim dhe trajnim profesional sipas dispozitave të këtij ligji;
- të propozojë ndryshime dhe plotësime të planeve dhe programeve ekzistuese mësimore ose të propozojë plane dhe programe të reja mësimore;
- të mund të inkuadrohet në aktivitete komerciale dhe ekonomike, ndërsa mjetet financiare të fituara nga këto aktivitete të shfrytëzohen për përmirësimin e kushteve të punës në institucion.

Institucioni për arsim dhe trajnim profesional e ka për obligim:

- të sigurojë kushte pune në kuadër të procesit arsimor dhe trajnimit;
- t'i përmbushë obligimet nga marrëveshjet për trajnim;
- marrëveshjet për trajnim t'i paraqesë pranë dhomave;
- të bëjë inspektim mbi realizimin e marrëveshjeve për trajnim;
- që punëdhënësve me kohë t'ua sigurojë informatat për ndryshimet rrjedhëse në planet dhe programet mësimore.

#### ***Të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve të inkuadruar në trajnimin praktik***

Neni 15

Punëdhënësi ka të drejtë:

- të ketë lehtësime financiare, doganore dhe tatimore, të përcaktuara me ligj;
- të propozojë ndryshime dhe plotësime të planeve dhe programeve ekzistuese mësimore ose të propozojë plane dhe programe të reja mësimore.

Punëdhënësi ka obligim:

- t'i arrijë qëllimet e trajnimit praktik nga programet mësimore në përputhje me fondin e orëve të parapara;

- të lidhë marrëveshje me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe me nxënësin, për realizimin e trajnimit praktik;
- të sigurojë kompensim për punën e nxënësit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen;
- të sigurojë mbrojtje gjatë punës, në përputhje me ligjin.

### *Marrëveshjet për trajnim*

#### Neni 16

Për periudhën e kaluar në trajnim, lidhet marrëveshje për trajnim ndërmjet institucionit për arsim dhe trajnim profesional, punëdhënësit dhe nxënësit, kurse për nxënësin e mitur marrëveshjen e nënshkruan prindi, përkatësisht tutori i nxënësit.

Në marrëveshjen nga paragrafi 1 i këtij neni, rregullohen kushtet për trajnim, punë dhe për kompensimin e punës.

Para fillimit të trajnimit praktik, marrëveshja duhet të jetë nënshkruar dhe i regjistruar në Regjistrin e nxënësve që kanë lidhur marrëveshje për trajnim praktik me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin.

Dhomat mbajnë Regjister të nxënësve që kanë lidhur marrëveshje për trajnim praktik me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin.

Dhomat çdo tre muaj dorëzojnë raport për marrëveshjet e lidhura për trajnim praktik të nxënësve me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin të Ministria dhe të Qendra.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të nxënësve që kanë lidhur marrëveshje për trajnim praktik me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin, i përcakton ministri.

#### Neni 17

Përmbajtja, forma dhe procedura e nënshkrimit të marrëveshjes për trajnim, përcaktohet nga dhomat.

### *Llojet e arsimit profesional, kohëzgjatja dhe nivelet e kualifikimeve profesionale*

#### Neni 18

Arsimi dhe trajnimi profesional realizohet përmes planeve dhe programeve mësimore për:

1. **Aftësim profesional** të dedikuar për punë me kërkesa më të ulëta i cili jep njohuri dhe shkathtësi praktike në fusha të ndryshme të punës.

Në programet për aftësim profesional mund të inkuadrohen nxënësit të cilët e kanë kryer arsimin fillor dhe ata të cilët nuk e kanë kryer arsimin fillor, por me obligim që paralelisht me aftësimin profesional ta kryejnë edhe arsimin fillor.

Aftësimi profesional, varësisht nga ndërlikimi i profesionit zgjat deri më dy vjet. Pas kryerjes së aftësimit profesional nxënësit do të pajisen me nivelin e I të kualifikimeve profesionale.

Nxënësit me aftësim profesional të kryer me kohëzgjatje prej së paku një viti, arsimimin e tyre mund ta vazhdojnë në vitin e dytë të arsimit profesional përkatës për profesion.

**2. Arsimi profesional** për profesion është i dedikuar për t'i përmbushur nevojat e ekonomisë. Në arsimin profesional për profesion, në vitin e parë mund të regjistrohen nxënës me arsim të kryer fillor.

Arsimi profesional për profesion zgjat tre vjet.

Arsimi profesional për profesion realizohet në shkollën për arsim dhe trajnim profesional, ndërsa trajnimi praktik realizohet në shkollë dhe te punëdhënësi.

Me kryerjen e arsimit të mesëm profesional për profesion, nxënësit pajisen me nivelin II të kualifikimit profesional.

Nxënësit me arsim të kryer profesional për profesion, arsimimin e tyre mund ta vazhdojnë në vitin e katërt të arsimit teknik ose së paku pas tre vjetësh pune praktike të inkuadrohen në programe për arsim dhe trajnim profesional pas arsimit të mesëm (në tekstin e mëtejshëm: arsim pas arsimit të mesëm).

**3. Arsimi teknik** është arsim i cili fillimisht përgatit kuadro për t'u punësuar në të gjitha fushat e punës, por edhe për ta vazhduar arsimimin.

Në arsimin teknik në vitin e parë mund të regjistrohen nxënës me arsim të kryer fillor ose me aftësim të kryer profesional.

Arsimi teknik zgjat katër vjet.

Me kryerjen e arsimit teknik, nxënësit do të pajisen me nivelin e III të kualifikimeve profesionale.

Nxënësit me arsim teknik të kryer, arsimimin e tyre mund ta vazhdojnë edhe në arsimin pas arsimit të mesëm, në bazë të programeve në vazhdimësi ose pas dy vjetësh përvojë pune.

Nxënësit me arsim të kryer teknik, arsimimin e tyre mund ta vazhdojnë në arsimin sipëror profesional.

Nxënësit me arsim të kryer teknik, arsimimin e tyre mund ta vazhdojnë edhe në institucionet e arsimit sipëror, nëse pajisen me maturën shtetërore.

**4. Arsimi dhe trajnimi pas arsimit të mesëm**, është arsim i cili në mënyrë përfundimtare përgatit kuadër për detyra të caktuara profesionale në segmente të veçanta të procesit të punës. Nxënësit, pasi që ta kryejnë arsimin pas arsimit të mesëm, do të pajisen me nivelin e IV të kualifikimeve profesionale.

Nxënësit me arsim të kryer pas arsimit të mesëm, arsimimin e tyre mund ta vazhdojnë në arsimin sipëror profesional.

Mënyrën dhe procedurën e kalimit prej një dege në degë tjetër të arsimit profesional e përcakton ministri.

**5. Arsimi i të rriturve** realizohet në institucionet për arsim dhe trajnim profesional si pjesë integrale e mësimit të përjetshëm, i cili i lidh segmentet dhe format e veçanta të arsimit në një sistem unik.

Mënyra e realizimit, planifikimit, programimit, organizimit, menaxhimit dhe financimit të arsimimit të të rriturve rregullohet me ligj të veçantë.



## *Provimet në fund të arsimit dhe trajnimit profesional*

### Neni 19

Pas kryerjes së secilës degë të arsimit dhe trajnimit profesional jepet: provimi për aftësim profesional, provimi përfundimtar, matura shtetërore, provimi i specializimit dhe provimi i mjeshtrit.

Nxënësit të cilët e kanë kryer arsimin pas arsimit të mesëm, japin provimin special, përkatësisht provimin e mjeshtrit

Nxënësit të cilët e kanë kryer arsimin teknik, e japin maturën shtetërore, përkatësisht provimin përfundimtar.

Nxënësit të cilët kanë kryer arsim profesional për profesion, japin provim përfundimtar.

Nxënësit të cilët kanë kryer aftësim profesional, japin provim për aftësim profesional.

### Neni 20

Programet e provimeve për provimin e mjeshtrit dhe programet e provimeve për aftësim profesional të veprimtarive të zejeve, i miraton Dhoma e Zejtarëve të Maqedonisë, sipas pëlqimit paraprak të ministrit.

Programet e provimeve për provimin special i përpilon Qendra në Bashkëpunim me Dhomën Ekonomike të Maqedonisë, ndërsa i miraton ministri.

Struktura, organizimi dhe realizimi i provimeve në fund të çdo dege të arsimit dhe trajnimit profesional, do të rregullohet me akt nënligjor dhe me koncept për maturën shtetërore dhe për provimin përfundimtar, të cilat i miraton ministri.

## *Diploma, vërtetime*

### Neni 21

Diplomat dhe vërtetimet që i njeh shteti, janë:

- Vërtetimi për aftësim profesional;
- Diploma për provimin përfundimtar;
- Diploma për maturë shtetërore;
- Diploma për arsim të specializuar;
- Diploma për provimin e mjeshtrit;

Përmbajtjen, formën e formularit dhe mënyrën e dhënies së diplomave dhe vërtetimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, e përcakton ministri.

## *Të drejtat dhe obligimet e nxënësve në arsimin dhe trajnimin profesional*

Neni 22

Nxënësit kanë të drejtë:

- të kalojnë nga një degë në degë tjetër të arsimit dhe trajnimit profesional, përkatësisht nga njëri nivel në nivel tjetër të kualifikimeve profesionale;
- gjatë kohës së trajnimit të marrin kompensim për punën që kryejnë te punëdhënësi, të përcaktuar në marrëveshje;
- ta shfrytëzojnë pushim veror dhe dimëror;
- ta prishin marrëveshjen, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje.

Nxënësit kanë obligim:

- për kontroll intern dhe ekstern, të përparimit dhe arritjes së suksesit,
- me rregull ta përcjellin trajnimin praktik dhe t'i përmbushin obligimet e punës të përcaktuara në marrëveshje;
- gjatë trajnimit t'i ndjekin udhëzimet e punës të punëdhënësit dhe shkollës gjatë kohës së trajnimit praktik;
- ta ruajnë sekretin zyrtar të punëdhënësit;
- t'i respektojnë rregullat e mbrojtjes gjatë punës;
- t'i përmbushin dhe obligimet e tjera të cekura në marrëveshje.

Të drejtat dhe obligimet e tjera të nxënësve janë përcaktuar në Ligjin për arsim të mesëm dhe në rregulla të tjera.

## *Përmbajtja e arsimit dhe trajnimit profesional*

Neni 23

Arsimi dhe trajnimi profesional përmban:

- arsimim të përgjithshëm;
- arsimim teorik-profesional;
- trajnim praktik.

## **IV. ARSIMI DHE TRAJNIMI PAS ARSIMIT TË MESËM**

### *Përmbajtja e arsimit dhe trajnimit pas arsimit të mesëm*

Neni 24

Arsimi dhe trajnimi pas arsimit të mesëm realizohet përmes planeve dhe programeve mësimore për:

- arsimin e specializuar;
- provimin e mjeshtrit.

### *Qëllimet e arsimit dhe trajnimit pas arsimit të mesëm*

Neni 25

Arsimi dhe trajnimi pas arsimit të mesëm, siguron aftësim më të thellë për punë e cila kërkon posedim të kompetencave specifike, dije dhe shkathtësi nga teknologjia, organizimi dhe menaxhimi i punëve operative në prodhimtarinë dhe shërbimet.

### *Institucionet për arsim pas arsimit të mesëm*

Neni 26

Institucioni për arsim dhe trajnim pas arsimit të mesëm është institucion veprimtaria e të cilit është që të sigurojë arsim dhe trajnimin pas arsimit të mesëm.

Arsim dhe trajnim pas arsimit të mesëm mund të realizohet në institucione publike dhe private, të verifikuara nga ministria.

Kushtet për verifikimin e institucioneve për arsim dhe trajnim pas arsimit të mesëm janë:

- të ketë siguruar mjete financiare të nevojshme për punë;
- t'i ketë miratuar planet dhe programet mësimore për arsim dhe trajnim pas arsimit të mesëm;
- të ketë siguruar pajisje, lokal, kuadër përkatës për të gjitha lëndët sipas standardeve dhe normave pedagogjike.

Standardet dhe normat nga paragrafi 3 i këtij neni, i përpilon Qendra, ndërsa i miratojnë dhomat sipas mendimit pozitiv paraprak të ministrisë.

### *Regjistrimi në institucione për arsim dhe trajnim pas kryerjes së arsimit të mesëm*

Neni 27

Në institucione për arsim dhe trajnim pas kryerjes të arsimit të mesëm mund të regjistrohen persona të cilët janë të punësuar te punëdhënës ose janë të pa punësuar dhe të cilët:

- dëshirojnë t'i përsosin kualifikimet e tyre;
- dëshirojnë të fitojnë specializim të ri.

Personat nga paragrafi 1 të këtij neni mund të regjistrohen në arsim dhe trajnim pas kryerjes së arsimit të mesëm vetëm nëse kanë mbaruar arsim teknik ose arsim profesional për profesion, në pajtim me nenin 18 nga ky ligj.

Në arsimin e specializuar mund të përfshihet edhe personi i cili ka kryer arsim të gjimnazit ose të arteve dhe me përvojë pune adekuate trevjeçare.

## ***Të drejtat dhe obligimet e personave të përfshirë në arsim dhe trajnim pas kryerjes së arsimit të mesëm***

Neni 28

Të drejtat dhe obligimet të personave të regjistruar në institucionet për arsim dhe trajnim pas kryerjes së arsimit të mesëm përcaktohen në marrëveshje të lidhur ndërmjet personit pjesëmarrës dhe institucionit për arsim dhe trajnim pas kryerjes së arsimit të mesëm.

## ***Plane dhe programe mësimore për arsim dhe trajnim pas kryerjes së arsimit të mesëm***

Neni 29

Arsimi dhe trajnimi pas kryerjes së arsimit të mesëm realizohen sipas planeve dhe programeve mësimore të cilat janë të dizajnuara në mënyrë modulare.

Planet dhe programet mësimore nga paragrafi 1 të këtij neni për arsim special i propozon Qendra, ndërsa i miraton ministri. Planet dhe programet mësimore nga paragrafi 1 të këtij neni për provim mjeshtri i përpilon Qendra, ndërsa i miraton Dhoma e Zejtarëve të Maqedonisë, pas mendimit paraprak pozitiv të ministrisë.

Pjesë nga modulet në arsimin pas kryerjes së arsimit të mesëm pranohen si kredi gjatë pranimit në arsim sipëror profesional.

## **V. QENDRA PËR ARSIM DHE TRAJNIM TË MESËM PROFESIONAL**

### ***Themelimi***

Neni 30

Qendra për arsim dhe trajnim profesional është institucion publik për arsim dhe trajnim profesional në Republikën e Maqedonisë.

Qendrën e themelon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Qendra për arsim dhe trajnim profesional e ka cilësinë e personit juridik.

Selia e Qendrës është në Shkup.

Neni 31

Në Qendër harmonizohen dhe integrohen interesat publike dhe interesat të partnerëve socialë në arsimin dhe trajnimin profesional në Republikën e Maqedonisë.

Qendra e koordinon bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në sferën e arsimit dhe trajnimit profesional.

Qendra i kryen punët si vijon:

- e zhvillon arsimin dhe trajnimin profesional për shkak të harmonizimit të nevojave me zhvillimin bashkëkohor teknologjik dhe shoqëror;
- u jep përkrahje partnerëve socialë në të gjithë nivelet dhe faza në planifikimin, zhvillimin dhe realizimin e arsimit dhe trajnimit profesional;
- e ndërlikohet arsimin dhe punën në kontekst të mësimin të përjetshëm;
- e zhvillon në orientim evropian arsimin profesional, me transparentë dhe konkurrencë të siguar të kompetencave profesionale të fituara, të përshtatura për nevojat e tregut ndërkombëtar të punës;
- kryen hulumtime të tregut të punës në bashkëpunim me partnerët socialë;
- merr pjesë në zbatimin e procedurave për akreditim për sigurimin e shërbimeve në lidhje me zbatimin e programeve për trajnim të kuadrit adekuat të lëndëve profesionale - teorike dhe trajnim praktik;
- përgatit koncepte për të gjitha llojet e arsimit profesional dhe trajnim;
- përpilon standarde të profesioneve, si bazë për përpunimin e programeve dhe planeve mësimore;
- propozon dhe zhvillon plane mësimore për të gjitha llojet dhe nivelet e arsimit profesional dhe trajnim dhe të njëjtat i dorëzon për mendim të Biroja për Zhvillimin e Arsimit;
- përpilon modele të programeve mësimore për lëndët profesionale për arsim profesional dhe trajnim;
- i zbaton furnizimet publike për sigurimin e kushteve në përpilimin e programeve të reja mësimore për lëndët profesionale, gjegjësisht modernizimin e programeve mësimore ekzistuese të lëndëve profesionale, në pajtim me ligjin;
- e përcjell kryerjen e shërbimeve të ofertuesve e zgjedhur të shërbimeve, në lidhje me kualitetin dhe kryerjen e shërbimeve sipas afateve të përcaktuara;
- propozon programe për provime, në pajtim me standardet për zbatimin e provimeve në fund të secilit lloj të arsimit profesional dhe trajnim;
- i përcjellë rezultatet nga provimet në fund të secilit lloj të arsimit profesional dhe trajnim;
- përpilon dhe propozon Listën e standardeve për profesione për arsim profesional dhe trajnim;
- siguron përkrahje të arsimit profesional përmes këshillimit, instruktimit dhe mentorimit të arsimtarëve dhe trajnuesve për lëndët profesionale në arsimin profesional dhe trajnim;
- i propozon Qendrës Shtetërore të Provimeve, teste për kontroll ekstern të arritjeve të nxënësve në lëndët profesionale, në arsimin e mesëm profesional, të cilat i dorëzon më së voni tre muaj para ditës së testimit,
- i propozon Qendrës Shtetërore të Provimeve, orar të përgjithshëm për kontrollin e arritjeve të nxënësve në lëndët profesionale në arsimin e mesëm profesional, të cilin e dorëzon më së voni deri më 1 nëntor, për vitin rrjedhës shkollor,
- përgatit propozim-masa për përmirësimin e kualitetit të mësimin dhe vlerësimit të mësimdhënësve për lëndët profesionale dhe
- zhvillon program për përmirësimin e kualitetit të mësimin për lëndët profesionale në shkollë, në bazë të raportit nga evoluimi integral i realizuar, nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.
- u jep mendime për plotësimin e kushteve institucioneve të cilat kërkojnë verifikim për realizimin e arsimit profesional dhe trajnim;
- përpunon standarde për hapësirë dhe pajisje të shkollave;

- ndërmjetëson në zhvillimin e karrierës dhe orientimin profesional të nxënësve në arsimin profesional dhe trajnim;
- propozon zgjidhje për përmirësimin e lidhjeve ndërmjet arsimit profesional dhe arsimit fillor, arsimit profesional dhe arsimit të përgjithshëm dhe arsimit profesional dhe arsimit sipëror.
- propozon standarde për arritjet e nxënësve në arsimin dhe trajnimin profesional dhe
- propozon standarde për profile arsimore dhe standarde për degë profesioni.

Neni 33

Qendra bashkëpunon me:

- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës;
- Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale;
- Ministrinë e Ekonomisë;
- Agjencia për Punësim të Republikës së Maqedonisë;
- Enti Shtetëror për Statistikë;
- Dhomën Ekonomike të Maqedonisë;
- Dhomën e Zejtarëve e Maqedonisë;
- Sindikatën;
- Byronë për Zhvillimin e Arsimit;
- Qendrën Shtetërore për Provim;
- institucionet për arsim dhe trajnim profesional;
- universitetet në Republikën e Maqedonisë;
- institucionet dhe organizata ndërkombëtare nga sfera e arsimit dhe trajnimit profesional.

### *Fshehtësi e materialeve të provimeve*

Neni 33-a

Punonjësit në Qendër dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, të cilët bashkëpunojnë me Qendrën Shtetërore të Provimeve, në përgatitjen e testeve për kontrollin ekstern të arritjeve të nxënësve, janë të obliguar që të nënshkruajnë deklaratë, se do të udhëhiqen sipas procedurave për fshehtësinë e përgatitjes, shpërndarjes dhe ruajtjes së materialit për kontrollin ekstern të arritjeve të nxënësve.

Procedurat për fshehtësinë e përgatitjes, botimit, shpërndarjes, ruajtjes dhe vlerësimit të materialit të provimit, i përgatit Qendra Shtetërore e Provimeve, ndërsa i përcakton ministri.

Neni 33-b [2](#)

Të punësuarit në Qendrën të cilët kryejnë punë administrative kanë status të nëpunësve administrativë dhe për ato zbatohen dispozitat nga Ligji për nëpunës administrativë dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik.

Të punësuarit në Qendrën të cilët kryejnë punë ndihmëse dhe teknike kanë status të personelit ndihmës teknik.

Për personelin ndihmës teknik në Qendrën do të zbatohet Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

### *Administrimi dhe udhëheqja me Qendrën*

Neni 34

Me Qendrën administron këshilli drejtues.

Këshilli drejtues është i përbërë nga nëntë anëtarë edhe atë nga një anëtar nga ministria, ministria kompetente e punës, Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale, nga një anëtar nga dhomat dhe katër anëtarë nga radhët e punëtorëve profesionalë të punësuar në Qendër.

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit drejtues zbatohet parimi i përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, duke pasur parasysh gjuhët në të cilat mbahet mësimi në arsimin e mesëm, pa u prishur, cenuar kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat pesë vjet.

Anëtarët e Këshillit drejtues i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 35

Këshilli drejtues i Qendrës:

- miraton Statutin e Qendrës;
- miraton programin vjetor për punën të Qendrës;
- propozon planin vjetor financiar dhe llogarinë përfundimtare të Qeveria e Republikës së Maqedonisë;
- boton shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit në së paku tre gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase; [3](#)
- bën intervistë me kandidatët për drejtor nga kandidatët e paraqitur;
- bën zgjedhjen e drejtorit nga kandidatët e paraqitur në shpalljen publike të botuar;
- publikon shpallje publike për zgjedhjen e zëvendës-drejtorit në së paku tre gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase; [4](#)
- bën intervistë me kandidatët për zëvendës-drejtor nga kandidatët e paraqitur;
- bën zgjedhjen e zëvendës-drejtorit nga kandidatët e paraqitur pas publikimit të shpalljes publike;
- vendos sipas kundërshtimeve dhe ankesave të të punësuarve në Qendër;
- kryen punë të tjera të përcaktuara me Statut.

Pëlqim për Statutin e Qendrës jep Ministria.

5

(1) Për drejtor të Qendrës mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/I;
- 4) të jetë arsimtar me së paku pesë vjet përvojë pune në arsimin profesional ose të jetë i punësuar së paku pesë vjet në organ të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e arsimit;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: 6
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
  - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
  - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë,
  - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
  - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

Mandati i drejtorit të Qendrës zgjat pesë vjet.

7

(1) Për zëvendësdrejtor të Qendrës mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/1;
- 4) të jetë arsimtar me së paku pesë vjet përvojë pune në arsimin profesional ose të jetë i punësuar së paku pesë vjet në organ të administratës kompetent për punët nga sfera e arsimit ose decentralizimit;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: 8 .
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
  - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
  - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë,
  - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
  - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

(2) Mandati i zëvendësdrejtorit të Qendrës zgjat pesë vjet.



Neni 37

Drejtori i Qendrës:

- organizon dhe udhëheq me punën e Qendrës;
- të përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Qendrës;
- përfaqëson Qendrën para personave të tretë;
- propozon programin vjetor për punën e Qendrës;
- zbaton vendimet e Këshillit drejtues të Qendrës;
- vendos për të drejtat nga marrëdhënia e punës e të punësuarve në Qendër;
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me Statutin e Qendrës.

## **VI. FINANCIMI I PUNËS SË QENDRËS**

Neni 38

Mjetet për realizimin e veprimtarisë së Qendrës sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga hyrje të veta nga shërbimet e kryera:

- legatat, dhuratat, donacionet;
- burime të tjera.

## **VII. MBIKËQYRJA**

Neni 39

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të këtij ligji e kryen ministria.

Neni 39-a

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese Inspektorati Shtetëror i Arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës konstaton se për herë të parë është kryer parregullsi nga neni 40 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, detyrohet të përpilojë procesverbal në të cilin do ta konstatojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanim të parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëhershëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose punëdhënësit të i cili është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e njoftimit për edukim si dhe mënyrën e realizimit të edukimit i përcakton ministri.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Arsimit përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës, që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e realizimit të mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të ngjashme për një ose më shumë persona, ose një ose më shumë punëdhënës.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose punëdhënësi për të cilin realizohet edukimi nuk lajmërohet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi ose punëdhënësi për të cilin realizohet edukimi lajmërohet në edukimin e caktuar dhe të njëjtin e kryen, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e konstatuar.

(7) Nëse Inspektorati Shtetëror i Arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërprente procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse Inspektorati Shtetëror i Arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës, që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri.

## **VIII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE**

### Neni 40

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 2.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit nëse:

- nuk lidhë marrëveshje me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe me nxënësin për realizimin e trajnimit praktik (nenet 15 dhe 16) dhe
- nuk siguron kompensim për punën e nxënësit, në pajtim me kushtet e përcaktuara me marrëveshje (neni 16).

(2) Gjobë në shumë prej 1.250 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të punëdhënësi, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 3.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit, nëse:

- kryen trajnim praktik për nxënës para miratimit të aktvendimit për përmbushjen e kushteve lidhur me lokalitetin, pajisjen dhe kuadrin adekuat (neni 13) dhe
- nuk siguron mbrojtje gjatë punës në pajtim me ligjin (neni 15 paragrafi (2) alineja 4).

(4) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të punëdhënësi, për kundërvajtje nga paragrafi (3) i këtij neni.

Neni 40-a

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje të punësuarit përkatësisht bashkëpunëtorit të jashtëm, nëse nuk e nënshkruan deklaratën e përcaktuar në nenin 33-a paragrafi (1) të këtij ligji

## **IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

Neni 41

Shkollat e mesme publike në të cilat realizohen arsimi profesional dhe trajnimi në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do ta harmonizojnë organizimin e vet, punën, statutet dhe akte tjera të përgjithshme të shkollës me dispozitat nga ky ligj.

Neni 42

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta themelojë Qendrën për arsim dhe trajnim të mesëm profesional në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta themelojë Këshillin për arsim dhe trajnim të mesëm profesional në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 43

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të nxirren në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 44

Të punësuarit në Byronë për Zhvillimin e Arsimit, të cilët punojnë në punët e arsimit dhe trajnimit profesional vazhdojnë me punë si të punësuar në Qendrën për Arsim dhe Trajnim Profesional nga dita e themelimit të saj.

Mjetet, pajisja, inventari, dokumentacioni të lidhura me punën e të punësuarit nga paragrafi 1 të këtij neni i ndërmerret Qendra nga dita e themelimit të saj.

Neni 45

Dispozitat e Ligjit për arsimin e mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55 /2005 dhe 113/2005 dhe 35/2006) të cilat kanë të bëjnë me arsimin e mesëm profesional pushojnë të vlejnjë me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".